



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

**KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE**

**VENDIM**

**Nr. 205, dt.25.09.2015**

Në mbështetje të nenit 17, pika 3, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, bazuar dhe në rregulloren “Mbi kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e licensave të ushtrimit të profesionit të restauratorit”, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 25.09.2015, pasi shqyrtoi kërkesën për licensim në fushën e restaurimit për *ing. Dhimitër Kondakçi*,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë kërkesën për pajisje me licensë restaurimi personale profesionale në fushën e restaurimeve për kategorinë AP. “**Projektim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës**”, me nënkategoritë AP/2, AP/3, AP/4, sipas rregullore “Mbi kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e licensave të ushtrimit të profesionit të restauratorit” të *ing. Dhimitër Kondakçi*.
  2. T’i propozojë Ministrit të Kulturës, pajisjen e *ing. Dhimitër Kondakçi*, me licensë restaurimi personale profesionale në fushën e restaurimeve për kategorinë AP. “**Projektim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës**”, me nënkategoritë AP/2, AP/3, AP/4.
  3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
  4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**MIRELA KUMBARO FURXHI**



**SEKRETAR I KKR**

**ARTA DOLLANI**